

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Studim fushor, për krijimin e sistemit të informacionit të tokës (LIS) i integruar në (GIS) në katër njësi administrative në 9,000 ha tokë bujqësore”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Projekte, 22114311-5.

Vlera e fondit limit: 9,983,333 (nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tredhjetë e tre) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri me date 20.12.2026.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiar (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më vogël se 39% e vlerës së përlogaritur të kontratës. *(Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 **Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi projektimi për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

8. PROJEKTUES GJEODET

- b- Rilevime inxhinierike kadastrale
- c- Sistemet GIS
- e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore. Kategoria e kërkuar e licencës është kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit të kërkuar dhe termave të references të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor përfitues e cila shërben për të rritur besueshmërinë dhe sigurinë që produkti final do të jetë në përputhje me kërkesat dhe objektin ku konkretisht kërkohet: Realizimin e studimeve fushore, inventarizimin dhe klasifikimin e tokave bujqësore, kryerjen e sondimeve dhe profileve të tokës, administrimin e të dhënave gjeohapësinore, përpunimin dhe integrimin e informacionit në Sistemin e Informacionit të Tokës (LIS) të integruar me Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS), si dhe hartimin e hartave tematike, bazave të të dhënave dhe raporteve teknike sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentacionin teknik.

b- “Rilevime inxhinierike kadastrale” -- Terma references përfshin mbledhjen, verifikimin dhe përpunimin e të dhënave kadastrale në nivel parcele, identifikimin e zonave kadastrale, lidhjen e informacionit hartë-kartelë, si dhe integrimin e këtyre të dhënave në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS).

c- “Sistemet GIS” -- qëllimi kryesor i kontratës është krijimi i Sistemit të Informacionit të Tokës (LIS) të integruar në GIS. Vetë objekti i procedurës përcakton krijimin e një sistemi GIS për administrimin e të dhënave mbi tokën bujqësore.

e- “Projektim fotogrametrik dhe hartografik” -- përfshin përpunimin e ortofotove, interpretimin e fotografive ajrore, hartimin e hartave tematike dhe përgatitjen e produkteve kartografike. Interpretimin e ortofotove për identifikimin e përdorimit të tokës, përpilimin e hartave të tipeve të tokës.

2.3.3 Një punësim minimalisht prej 5 (pesë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Kërkesa për stafin bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i përcaktuar është si rezultat i analizës së volumit të shërbimit, afatit të kontratës dhe organizimit minimal të nevojshëm për realizimin e saj. Ky kriter është në proporcion me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkimi i listëpagesës së muajit të fundit dhe vërtetimit nga Administrata Tatimore synon të provojë se operatori ekonomik disponon ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.4 Operatori/ët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të përfshirë në licensën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik

Për stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontraten individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i procedurës nuk konsiston vetëm në evidentimin fizik të njësive të ulla, por përfshin edhe aktivitete të specializuara të karakterit gjeodezik dhe gjeohapësinor, të cilat kërkojnë drejtim teknik nga një specialist i fushës. Për këtë arsye, vlerësohet se prania e të paktën një inxhinieri të kësaj fushe është kusht minimal dhe proporcional me objektin e kontratës. Kërkesa që ky specialist të jetë i punësuar dhe të paraqitet kontrata e punës, diploma dhe CV-ja synon të garantojë disponueshmërinë reale të ekspertit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Inxhinieri i diplomuar në një nga fushat e mesiperme garanton dhe është përgjegjës i organizimit teknik të punimeve; metodologjisë që do të ndiqet për mbledhjen e të dhënave; do të koordinojë punën e ekipeve në terren; etj kontrollin teknik të matjeve; kontrollin e cilësisë së të dhënave përpara regjistrimit në sistem.

Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik nevojitet per mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe integrimin e të dhënave gjeohapësinore në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS), si dhe realizimin e punimeve që lidhen me identifikimin e parcelave, zonave kadastrale dhe hartografimin e territorit etj.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të kete pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontrate pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik
- 1 (një) specialist të pajisur me certifikate të trajnimit kombëtarë ose ndërkombëtarë ne programet GIS ose programe ekuivalente . Certifikimi i kërkuar mund të zotërohet edhe nga stafi i sipërcituar.
- 2 (dy) specialiste agronomë

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- Kontraten individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV.

Ne rast se stafi i mesiperm do te jete i OE pjesemarres, duhet të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i kontratës konsiston në realizimin e studimit fushor për krijimin e Sistemit të Informacionit të Tokës (LIS) të integruar me Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) në katër njësi administrative, në një sipërfaqe prej rreth 9,000 ha tokë bujqësore. Shërbimi përfshin kryerjen e 1,464 sondimeve të tokës, hapjen dhe përshkrimin e 23 profileve të tokës, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave fushore, analizimin e përdorimit të tokës, interpretimin e ortofotove, dixhitalizimin e informacionit, krijimin e bazave të të dhënave në GIS, përgatitjen e hartave tematike, analizave statistikore dhe raporteve teknike. Për shkak të shtrirjes territoriale, volumit të punës dhe afatit të realizimit, aktivitetet duhet të zhvillohen paralelisht në disa zona, duke kërkuar angazhimin e një stafi të mjaftueshëm profesional.

-1 (nje) Inxhinierë Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik. Këta specialistë janë të domosdoshëm për organizimin dhe koordinimin e punës në terren, realizimin e matjeve dhe regjistrimin e koordinatave me GPS, administrimin e të dhënave gjeohapësinore, kontrollin e saktësisë së tyre, përpunimin paraprak të informacionit dhe mbështetjen e procesit të integritetit të të dhënave në GIS.

-1 (një) specialist i pajisur me certifikatë trajnimi kombëtare ose ndërkombëtare në programet GIS ose programe ekuivalente. Certifikimi i kërkuar mund të zotërohet edhe nga një prej specialistëve të mësipërm. Ky specialist është i domosdoshëm për administrimin, përpunimin, kontrollin e cilësisë, integrimin dhe organizimin e të dhënave në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS), si dhe për përgatitjen e hartave dhe bazave të të dhënave të kërkuara nga Termat e Referencës.

-2 (dy) specialistë Agronomë. Specialistët agronomë janë të domosdoshëm për realizimin e studimeve fushore të tokës, evidentimin dhe klasifikimin e karakteristikave të saj, identifikimin e tipeve të tokës, përshkrimin e profileve, marrjen e mostrave, analizimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore dhe hartimin e raporteve teknike sipas metodologjisë së përcaktuar në Termat e Referencës. Duke pasur parasysh numrin e lartë të sondimeve, profileve dhe sipërfaqen e madhe që do të mbulohet, angazhimi i dy specialistëve është proporcional me volumin e punës dhe garanton realizimin e studimit në përputhje me kërkesat teknike dhe afatet e kontratës.

Eshte parashikuar edhe mundësia që stafi i mesiperm sipas piken 2.3.4 te mund te sigurohet edhe nepermjet kontrates se punes apo kontrates se bashkepunimit enkas per kete kontrate. Kjo rrit konkurencen dhe siguron gare te barabarte. Vetem ne rast se stafi i mesiperm do te jete i Operatorit Ekonomik pjesemarres, duhet të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit. Ne rast se stafi i mesiperm sigurohet nepermjet kontrates se punes apo kontrates se bashkepunimit, nuk eshte kusht perfshirja ne list page se per muajin e fundit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përfitësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku percaktohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe ne nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 e vlefshme / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Kjo ISO konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e shërbimit që do të realizohet.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 2(dy) mjete transporti;
- 1(nje) dron profesional per matje topografike ;

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për pajisjet në pronësi ose me qera duhet dokumentacion (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4 gërma (ç) ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Përcaktimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara është bërë duke u bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit të parashikuar në Termat e Referencës, të cilat përfshijnë realizimin e studimeve fushore për krijimin e Sistemit të Informacionit të Tokës (LIS) të integruar me Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS), kryerjen e 1,464 sondimeve të tokës, hapjen dhe përshkrimin e 23 profileve të tokës, verifikimet në terren, identifikimin e përdorimit të tokës, interpretimin e ortofotove, si dhe grumbullimin dhe administrimin e të dhënave gjeohapësinore në një sipërfaqe prej rreth 9,000 ha tokë bujqësore.

-2 (dy) mjete transporti janë të domosdoshme për realizimin e shërbimeve në terren, duke marrë në konsideratë shtrirjen gjeografike të objektit në katër njësi administrative, sipërfaqen e madhe që do të mbulohet, numrin e lartë të pikave të sondimit dhe profileve të tokës, si dhe nevojën që ekipet e punës të operojnë njëkohësisht në zona të ndryshme, me qëllim respektimin e afateve të kontratës dhe garantimin e vazhdimësisë së procesit të studimit.

-1 (një) dron profesional për matje topografike është i nevojshëm për realizimin e verifikimeve në terren, mbledhjen e të dhënave gjeohapësinore, dokumentimin e zonave të studimit, mbështetjen e interpretimit të ortofotove, kontrollin e elementëve territorialë dhe krijimin e informacionit me saktësi të lartë, i cili do të përdoret gjatë përpunimit dhe integritetit të të dhënave në GIS. Përdorimi i kësaj pajisjeje kontribuon në rritjen e saktësisë së studimit, uljen e kohës së punës në terren dhe garantimin e cilësisë së produkteve përfundimtare të kërkuara në Termat e Referencës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, Termat e referencës janë hartuar në përputhje me nenin 36 të LPP 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.